



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KLOS
SEKTORI I FINANCËS

Nr. 2684 Prot.

Klos, më 28.09.2023

PROJEKT - VENDIM

Nr. ____, datë ____. ____. 2023

“PËR NJË NDRYSHIM NË VKB NR.53, DATË 23.08.2023 PËR MIRATIMIN E PAGAVE TË PUNONJËSVE TË BASHKISË KLOS”

Mbështetur në ligjin nr. 139/2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Neni 54, shkronja “ç” dhe „dh“, në ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, në ligjin nr.68/2017, “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.328, datë 31.05.2023, “Për Klasifikimin e Funksioneve, Grupimin e Njësive të Vetëqeverisjes Vendore, për Efekt Page dhe Caktimin e Kufijve të Pagave të Funkionarëve të Zgjedhur e të Emëruar, të Nëpunësve Civilë e të Punonjësve Administrativë të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.113, datë 01.03.2023, “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”, ligjit nr. 35/2023, “Për Kompetencat për Caktimin e Pagave, Trajtimeve të Tjera Financiare dhe Përfitimeve të të Punësuarve në Institucionet e Administratës Publike, si dhe të Pagës Bazë Minimale në Shkallë Vendi”, në vkm nr.326, datë.31.05.2023 “Për pagat e punonjësve mbështetëse dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike i kërkojmë Këshillit të Bashkisë të,

VENDOSË:

1-Të miratojë caktimin e kufijve të pagave, të administratorëve të Bashkisë Klos si më poshtë vijon :

Nr.	Njësia strukturore	Paga e grupit	Vjetërsi	Niveli i pozicionit	Niveli Aktual	Niveli i propozuar
1	Administrator për Nj.Adm me popullsi 5001-20000 banorë			50,000-95,000	80,900	85,000
2	Administrator për Nj.Adm me më pak se 5000 banorë			50,000-80,000	66,000	80,000

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

KRYETARI I BASHKISË

Valbona KOLA



Ad: Rr.“Jaho Hoxha”, Ndërtesa nr.2, Hyrja nr.2, Klos-Shqipëri, e-mail:bashkia.klos@yahoo.com

Relacion për Projekt-Vendimin “Për një ndryshim në VKB nr.53, datë 23.08.2023, Për miratimin e pagave të punonjësve të bashkisë Klos”

Mbështetur në ligjin nr. 139/2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Neni 54, shkronja “ç” dhe „dh“, në ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, në ligjin nr.68/2017, “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.328, datë 31.05.2023, “Për Klasifikimin e Funksioneve, Grupimin e Njësive të Vetëqeverisjes Vendore, për Efekt Page dhe Caktimin e Kufijve të Pagave të Funkionarëve të Zgjedhur e të Emëruar, të Nëpunësve Civilë e të Punonjësve Administrativë të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.113, datë 01.03.2023, “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”, ligjit nr. 35/2023, “Për Kompetencat për Caktimin e Pagave, Trajtimeve të Tjera Financiare dhe Përfitimeve të të Punësuarve në Institucionet e Administratës Publike, si dhe të Pagës Bazë Minimale në Shkallë Vendi”, si dhe bazuar në strukturën e miratuar të vitit 2023, duke patur parasysh që pozicioni i punës Administratorit është një pozicion me shumë ngarkesë në punë dhe shumë shpenzime për arsye të lëvizjeve që u duhet të kryejnë nëpër njësitë e tyre administrative për mbikqyrjen e territorit, kërkojmë që të bëhet rritja e nivelit të pagave.

Theksojmë që efekti financiar për këtë ndryshim në nivelin e pagave është rreth 46,100 lekë/muaj dhe do të mbulohet nga pozicionet e lira në strukturë.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

Përgjegjës i Sektorit të Financës

Silvana Bala

